

Luani, për ditëlindjen e tij, ka vendosur t'u blejë dhurata pesë shoqeve të tij (Edës, Sarës, Tinës, Sarandës dhe Hanës). Kështu, ai në pesë shitore të ndryshme (Remall, Albi Mall, ETC, Kipper dhe Pallma Mall) bleu pesë dhurata të ndryshme (çokollatë, balona, çamçakëza, pasqyrë dhe vathë). Në bazë të të dhënave të mëposhtme, gjeni se cilën dhuratë cilës shoqe ia ka dhuruar Luani!

	EMRI	SHITORJA					DHURATA				
		Remall	Albi Mall	ETC	Kipper	Pallma Mall	çokollatë	balona	çamçakëza	pasqyrë	vathë
DHURATA	Eda										
	Sara										
	Tina										
	Saranda										
	Hana										
	çokollatë										
	balonë										
	çamçakëza										
	pasqyrë										
	vathë										

Të dhënat:

- Luani i bleu vathët pasi ia kishte blerë dhuratën Sarës, por para se të shkonte në Pallma Mall.
- Edës nuk i takojnë as balonat as pasqyra.
- Në Pallma Mall Luani nuk i bleu as çamçakëzat as çokollatën.
- Luani nuk mundi të gjejë balona as në Albi Mall e as në Kipper.
- Çamçakëzat nuk u blenë as për Sarën e as për Hanën, ndërsa dhuratat e tyre nuk u blenë në Pallma Mall.
- Dhuratën Edës ia bleu para se t'ia blejë Sarës, por jo në Remall.
- Për Sarën Luani nuk e zgjodhi çokollatën, ndërsa Sarandës nuk ia zgjodhi balonat.
- Në Remall nuk janë blerë as çokollata as balonat.
- Hanës i pëlqeu dhurata, sepse i do ëmbëlsirat.
- Çamçakëzat nuk ishin as për Sarën, as për vajzën, dhurata e së cilës u ble në Pallma Mall.
- Dhurata e Tinës ishin vathët.
- Kiperi i ka çokollatat më të mira.

TABELA	Dhurata	Shitorja
Eda		
Sara		
Tina		
Saranda		
Hana		